



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## KPK KONFIRMON NË DETYRË ZNJ ALBANA BOKSI, GJYQTARE NË GJYKATËN E APELIT PËR KRIMET E RËNDA.

### Aspak transparencë në relatimin e çështjes lidhur me denoncimet e publikut

Më datë 4 Prill 2019, u zhvillua në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit seanca dëgjimore e Znj Albana Boksi, Gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Kryetarja e trupit gjykues në çelje të seancës verifikoi prezencën e palëve (vëzhguesit ndërkombëtar dhe subjektit) relatoi se trupi gjykues ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e dërguar nga organet ndihmëse, ka zhvilluar gjithashtu një procedurë të pavarur të tipit administrativ bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, ka dëgjuar subjektin e rivlerësimit, dhe për këto arsye ai e ka gjykuar të mbyllur hetimin për subjektin e rivlerësimit.

Lidhur me vlerësimin e pasurisë, në **raportin e ILDKPKI** konstatohet se: deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin, ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë, subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Në lidhje me kriterin e pasurisë, relatorja sqaroi se KPK ka kryer një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm përsa i përket vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore, burimin e krijimit të pasurisë, mundësinë për fshehje të pasurisë, deklarim të rremë apo konflikt interesi. Trupi gjykues ka vlerësuar gjithashtu provat dhe shpjegimet e paraqitura nga vetë subjekti i vlerësimit mbi rezultatet e këtij hetimi. Subjektit i është dhënë e drejta të njihet me rezultatet e hetimit dhe të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje.

Lidhur me kontrollin e figurës, **Drejtoria e sigurisë së informacionit të klasifikuar** ka paraqitur raportin me konstatimin se formulari i deklarimit është i plotë dhe i saktë, subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete të deklaruara nga vetë subjekti në deklaratën për kontrollin e figurës. Nga hetimi paraprak administrativ nuk ka pasur rrethana dhe prova nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme në lidhje me figurën e subjektit.

Lidhur me vlerësimin profesional KPK ka shqyrtuar raportin e dërguar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, informacionin e marrë nga burime të ligjshme si dhe dy denoncime të publikut të cilat pasi janë verifikuar kanë rezultuar se nuk përmbushnin kriteret e parashikuara nga ligji 84/2016. Lidhur me këto denoncime relatorja nuk sqaroi natyrën e tyre si dhe hetimin që ka kryer KPK duke mohuar të drejtën e publikut të njihet me thelbin e këtyre ankesave (duke e respektuar anonimatën).

Në përfundim të hetimeve paraprake KPK ka konstatuar gjithashtu se Subjekti i rivlerësimit ka aftësi të mira profesionale, organizative, ka nivel të lartë kritike dhe të vlerave profesionale, si dhe aftësi profesionale dhe angazhim profesional.

Në vazhdim të seancës Subjektit ju dha mundësia të japë shpjegime, si dhe të dorëzojë një kopje format me shkrim.

Znj Albana Boksi u shpreh se ishte dakord me të gjitha rezultatet e hetimit dhe se u qëndronte të gjitha shpjegimeve të dhëna gjatë procesit hetimor.

Në përfundim të seancës subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.